



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 8.1 nënparagrafi 8.1.2 të Rregullave (F03) për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteteve kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të miratuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eurofamis" SHA të datës 12.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi I fushave te futbollit ne Bardhosh, Bernice dhe Matiçan-RITENER" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjeserisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik NSH Eurofamis e datës 12.05.2023 kundër njoftimit për kontratë të autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 04.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi I fushave te futbollit ne Bardhosh, Bernice dhe Matiçan-RITENER" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1
- II. **KORIGJOHET** njoftimi për kontratë i autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 04.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi I fushave te futbollit ne Bardhosh, Bernice dhe Matiçan-RITENER" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1.
- III. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të bëjë zgajtjen e afatit të dorezimit të ofertave për të paktën 10 ditë prej datës së këtij vendimi.
- IV. **NJOFTOHET** menjëherë operatori ekonomik "Eurofamis" SH.A. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim, përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Faqe 1 nga 3

Operatori ekonomik " Eurofamis SHA (tutje si "parashtruesi") me datë 12.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 04.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi I fushave të futbollit në Bardhosh, Bernice dhe Matiqan-RITENER" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1.

Pretendimet e parashtruesit se janë bërë shkelje të nenit 1 Qëllimi i prokurimit, nenit 8 Planifikimi i prokurimit dhe nenit 9 -Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur janë të paqëndrueshme, OE nuk ka dhënë fakte dhe argumente që dëshmojnë se janë bërë shkelje të këtyre neneve madje edhe përmbajtja e tyre nuk përkon me pikat e cekura të parashkruesit të ankesës.

Pretendimi i parë i parashkruesit të Kërkesës për rishqyrtim është se në bazë të analizës së dosjes së tenderit dhe të përshkrimit të çmimeve nuk është bërë planifikimi i mirë i vlerës së parashikuar në krahasim me çmimet e tregut, dhe se edhe procedura e parë është anuluar për shkak të tejkalimit të vlerës së parashikuar.

Ky pretendim është i *pabazuar*, përcaktimi i vlerës së parashikuar është bërë në bazë të analizës në terren nga projektuesi të këtij aktiviteti, dhe se anulimi i aktivitetit për llot 1 në procedurën paraprake me titull: "Ndertimi I fushave të futbollit në Bardhosh, Bernice dhe Matiqan dhe me nr. të prokurimit: 616-23-2536-5-2-1, është bërë për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme, dhe se ka pasur oferta nën vlerës së parashikuar.

Pretendimi i dytë se AK duhet të bëjë ndryshimin e kërkesës në pikën 9.1 & 9.2 - *Për llot 1 OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar 3 projekte të ngjashme (vendosja e sistemit të ujitjes në fusha, dhe të paktën një projekt me punim të barit natyral), në tri vitet e fundit nga data e publikimit për kontratë dhe se në vend të saj duhet të kërkojë tri referenca të ngjashme është pjesërisht i bazuar.*

AK përmes këtij vendimi dhe Korigjimit të njoftimit do të bëjë ndryshim të kërkesës në pikën 9.1 & 9.2 për llotot 1 dhe atë si vijon: "OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar kontratë të natyrës së ngjashme në vlerë 100,000 euro në tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë".

Në përputhje me konstatimet si më sipër, autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës duke u bazuar në parimet e përgjithshme të Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik përkatësisht në nenin 7 lidhur me barazinë në trajtim, jo-diskriminimin dhe transparencën, do të bëjë korigjim të njoftimit për kontratë.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.05.2023



Faqe 2 nga 3

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-401-11

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.